

# Të vaksinuara kundër HPV

NJË ZGJEDHJE MË E MATUR

PARANDALIMI I INFEKSIONEVE DHE I TUMOREVE PËR:

- **Gra të reja (18-26 vjeç)**
- **Gra që u janë nënshtruar trajtimeve për dëmtime që kanë lidhje me HPV**
- **Gra me infektion nga HIV**



## ÇFARË ËSHTË PAPILOMA VIRUS (HPV)?

Bëhet fjalë për një grup virusesh shumë të përhapur. Ekzistojnë mbi 100 sierotipa, nga të cilat më shumë se 40 mund të shkaktojnë infeksione të aparatit gjeneral femëror dhe mashkullor. Në përgjithësi infeksionet nga HPV janë kalimtare, asimptomatike (d.m.th. personi nuk vëren asgjë) dhe në shumicën e rasteve shërohen spontanisht. Disa sierotipa HPV mund të shkaktojnë kondiloma ndërsa sierotipa të tjerë, që quhen me rrezik të lartë onkogjen, mund të shkaktojnë alterime qelizore në mukozën e qafës së mitrës, të vulvës, vagjinës, të anusit, penisit dhe të orofaringut të cilat, nëse janë të vazhdueshme dhe nëse nuk kurohen, mund të evoluojnë në tumore, në disa raste. Nga infeksioni deri në zhvillimin e tumorit mund të kalojnë madje edhe shumë vite.

## CILËT JANË VIRUSET HPV ME RREZIK TË LARTË ONKOGJEN DHE ÇFARË SHKAKTOJNË?

Viruset HPV 16 dhe 18 janë ndër përgjegjësit kryesorë të tumoreve dhe vetëm ata shkaktojnë mbi 70% të tumoreve të qafës së mitrës. Nëse marrim në konsideratë edhe sierotipat e tjerë si 31, 33, 45, 52 dhe 58, arrijmë në 90% të tumoreve të qafës së mitrës dhe rreth 80% të tumoreve të tjera që kanë lidhje me HPV. Karcinoma e qafës së mitrës (cerviksit uterin) ka qenë kanceri i parë që u njoh nga Organizata Botërore e Shëndetit (OBSh) që i atribuohet plotësisht një infeksioni viral.

## SI TRANSMETOHET PAPILOMA VIRUS?

Papiloma virus transmetohet nëpërmjet kontaktit intim me lëkurën ose mukozat dhe kryesisht nëpërmjet marrëdhënieve seksuale, edhe nëse nuk janë të plota. Është infeksioni më i zakonshëm që transmetohet me rrugë seksuale. Përdorimi i prezervativit zvogëlon, por nuk e parandalon, transmetimin e virusit pasi ky mund të jetë i pranishëm edhe në pjesët e lëkurës që nuk mbrohen nga prezervativi.

# Të vaksinuara kundër HPV

NJË ZGJEDHJE MË E MATUR



## SI DIAGNOSTIKOHET DHE SI KUROHET INFEKSIONI NGA HPV?

**Nuk ekziston një kurë specifike. Për të diagnostikuar në kohën e duhur alterimet në qelizat e qafës së mitrës të shkaktuara nga virusi HPV, është e nevojshme që t'i përmbahemi rregullisht ftesës për të kryer testin për screening HPV ose PAP testin.** Në këtë mënyrë do të jetë e mundur të vërejmë me kohë nëse po formohen alterime të dyshimta të mukozave të qafës së mitrës. Për vendet e tjera (vulvë, vagjinë, anus, penis dhe orofaring) nuk ekzistojnë programe për screening, prandaj në qoftë se mendojmë se jemi në rrezik infeksioni, duhet të konsultohemi me mjekun kurues ose një specialist të besuar.

---


## A ËSHTË E SIGURT VAKSINA? SI ËSHTË E BËRË?

**Vaksina është e sigurt.** Nuk përmban viruse të gjallë prandaj nuk mund të shkaktojë infeksion, por është në gjendje të induktojë një përgjigje imuniteti kundër virusit. Studimet e shumta të bëra deri më sot, si dhe sistemet eurvejimit post marketing të të gjitha vendeve evropiane dhe jo-evropiane, kanë demonstruar se vaksina tolerohet mirë. Miliona njerëz janë vaksinuar kundër HPV dhe nuk janë raportuar reagime të rënda. Mund të vërehen dhimbje dhe skuqje në zonën e injektimit, ethe, neveri, marramendje, dhimbje koke dhe dhimbje të kyçeve.

---

## A ËSHTË EFIKASE VAKSINA?

**Po, vaksina është efiikase.** Nuk është e nevojshme të kryhet testi HPV para vaksinimit. Studimet e fundit tregojnë se vaksina mund të parandalojë relapset te gratë që e kanë hasur tashmë virusin dhe kanë zhvilluar leziona prekanceroze ose kanceroze nëse soministrohet brenda 12 muajve nga trajtimi.



## A E PARANDALON INFEKSIONIN VAKSINIMI KUNDËR HPV?

Vaksina parandalon infeksionin nga sierotipat HPV që përmbahen në vaksinë dhe për këtë arsye ndalon edhe formimin e atyre alterimeve qelizore që mund të çojnë në tumor.

---

## PËR SA KOHË ZGJAT EFIKASITETI I VAKSINËS?

Studimet dëshmojnë qëndresën e antitropave për shumë vite, ndoshta gjatë gjithë jetës. Deri më sot, në fakt, nuk parashikohet asnjë përsëritje vaksinimi pas ciklit bazë.

---


## PËR KË REKOMANDOHET VAKSINIMI?

Vaksina ka si qëllim parandalimin e infeksionit, jo atë të shërimit: **pra duhet të soministrohet përpara kontaktit të mundshëm me virusin, domethënë përpara fillimit të marrëdhënieve seksuale.** Në qoftë se vajza ose djali tashmë kanë hyrë në kontakt me sierotipat e virusit që gjendet në vaksinë, efikasiteti zvogëlohet. **Edhe për personat e rritur është demonstruar se vakcina ruan një efikasitet të mirë,** megjithëse kjo zvogëlohet me kalimin e moshës për shkak të probabilitetit të lartë, sepse kanë pasur kontakte me virusin HPV për sa i përket aktivitetit seksual. Studimet e fundit mbi HPV tregojnë gjithashtu se **vakcina ka një rëndësi të madhe për gratë që e kanë hasur tashmë virusin duke zhvilluar leziona kanceroze;** në fakt, në këta paciente vakcina kryen një veprim parandalues për përsëritjen e tumoreve, nëse kryhet brenda 12 muajve nga ndërhyrja për heqjen e këtyre lezioneve.

---

## KU DHE SI KRYHET VAKSINIMI?

Vaksinimi kryhet nga operatorët sanitarë të ambulatorëve të vaksinimit të Ndërmarrjeve USL (Njësi sanitare lokale). Deri në moshën 15 vjeç cikli përfshin dy doza, duke filluar nga kjo moshë parashikohen tri doza përkundrazi. Bëhet fjalë për injeksione intramuskulore, zakonisht në deltoid (pjesa lart e krahut).



## ÇFARË U OFRON SHËRBIMI SANITAR RAJONAL GRAVE NË MOSHË TË RRITUR?

Vaksina që përdoret aktualisht në Emilia-Romagna është efikase kundër 9 tipave të papiloma virusit human (sierotipat 6, 11, 16, 18, 31, 33, 45, 52, 58) dhe mbron nga pothuajse 90% të tumoreve të qafës së mitrës, rreth 80% ndaj tipave të tjerë të tumoreve që kanë lidhje me HPV dhe pothuajse 100% të kondilomave.

**Vaksinimi ofrohet pa pagesë:**

- derisa të mbushin moshën 26 vjeç për të gjitha gratë e reja që nuk janë vaksinuar akoma për HPV (duke filluar nga viti 2019, vajzat 25-vjeçare do ta marrin falas ftesën për vaksinim)
- për të gjitha gratë, derisa të mbushin moshën 65 vjeç, me histori të dokumentuar të trajtimit të lezimeve të qafës së mitrës në shkallë të lartë (CIN2+) në 12 muajt e fundit
- për të gjitha gratë me infeksion nga HIV, duke bërë kërkesë.

Për të gjithë personat e rritur, duke përjashtuar ofertën falas, është ende e mundur të bëhet vaksinimi në ambulatorët e vaksinimit të Ndërmarrjeve USL, duke paguar një çmim të leverdishëm. Kostoja në ngarkim të pacientëve është dukshëm më e ulët se ajo që praktikohet privatisht dhe korrespondon vetëm me koston e vaksinës për Ndërmarrjen USL, plus koston e vaksinimit sipas tarifës rajonale. Për më shumë informacione, drejtohuni te Shërbimet sanitare dhe të higjienës publike, te Konsultoret ose te mjeku juaj dhe/ose gjinekologu.

## A MUND TË BËHET VAKSINIMI GJATË SHTATZËNISË?

**Vaksina nuk duhet t'u soministrohet grave shtatzëna.**

Në qoftë se një vajzë zbulon se është shtatzënë pas fillimit të ciklit të vaksinimit, ajo duhet të presë fundin e shtatzënisë para se ta përfundojë atë. Studimet klinike që janë kryer deri më sot nuk kanë demonstruar probleme të veçanta për gruan ose për fetusin. Sidoqoftë, janë duke u bërë studime më të thella.

## NË QOFTË SE JEMI VAKSINUAR A KA NEVOJË GJITHSESI QË TË BËJMË NJË SCREENING?

Po, meqenëse screening me anë të testit HPV ose të PAP testit lejon që të dalin në pah gjithashtu alterimet qelizore të qafës së mitrës të shkaktuara nga sierotipat e tjera të HPV që nuk përmbahen në vaksinë.



# Konsulto certifikatën tënde të vaksinimit në fashikullin sanitar elektronik

Fascicolo Sanitario  
●●●●● elettronico

PËR TË MËSUAR SE SI  
DUHET VEPRUAR  
**fascicolo-sanitario.it**

KOORDINIMI DHE SUPERVISIONI REDAKTUES:  
**Angela Lucarelli, Caterina Di Monte**

 **Regione Emilia-Romagna**



SERVIZIO SANITARIO REGIONALE  
EMILIA-ROMAGNA

**salute.regione.emilia-romagna.it**